



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Autoriteti i Konkurrencës
Autoritet za Konkurenciju - Competition Authority



Vendimi Nr. 69/23
Data: 20.07.2023

Duke u bazuar në nenin 11, 13, 15, 16, 17, 18, 26, 27 dhe 55 par 1.5 të Ligjit 08/L-056 Për Mbrojtjen e Konkurrencës dhe nenet 18 dhe 20 të Udhëzimit Administrativ Nr. 06/2012, Për Mënyrën e Paraqitjes së Kërkesës dhe Kriteret për Konstatimin e Përqendrimit të Ndërmarrjeve dhe Udhëzimit Administrativ Nr. 02/2018 Për Mënyrën e Përcaktimit të Tregut Relevant, Komisioni i Autoritetit të Konkurrencës, në mbledhjen e datës 20.07.2023, mori këtë:

V E N D I M

I. LEJOHET Përqendrimi i ndërmarrjeve: lidhur me marrjen e kontrollit të Editis Holding dhe blerjen e aksioneve 100% nga International Media Invest a.s.
Njoftimi për Përqendrim është i bazuar në Marrëveshjen lidhur me datë 23.04.2023, ndërmjet palëve IMI (**blerësi**) dhe Vivendi SE (**shitësi**) mbi/dhe Editis Holding, (targeti).

International Media Invest a.s. ("IMI") është shoqëri aksionare me numri të biznesit 07031939 me adresë të regjistruar, Pařížská 130/26, Josefov 110 00 Pragë 1, Republika Çeke. Aktiviteti i ndërmarrjes IMI, është pjesë e një grupi subjektsh aktive në botimin e gazetave dhe revistave si dhe revistave online në Republikën Çeke dhe në Francë, operimin e faqeve të internetit dhe transmetimin e radios në Republikën Çeke dhe Rumani (blerës).

Në Kosovë IMI e cila kontrollohet bashkërisht nga EP Corporata Group a.s (EPCG) është e pranishme përmes dy ndërmarrjeve:

Gjirafa Kosova LL.C, me numër të biznesit 810123860, me adresë në Graçanicë dhe

Gjirafa, Inc – Dega në Kosovë, me numër të biznesit 810840307, me adresë në Graçanicë

Të dy ndërmarrjet operojnë një motor-kërkimi, në gjuhën shqipe, një platformë për përmbajtje video/lajme, një platformë marketingu në internet.

Vivendi SE, një ndërmarrje franceze evropiane, (société européenne) me seli të regjistruar në adresën 42 Avenue de Friedland, 75008 Paris, e regjistruar në regjistrin për tregti të kompanive të Parisit, me numrin 343 134 763 e përfaqësuar nga Arnaud de Puyfontaine (shitës).

Editis Holding ("Editis") është shoqëri French Société Anonyme me numër të biznesit 452 942 451 RCS Paris, me adresë të regjistruar, 92 Avenues de France 75013 Paris, France. Aktiviteti i ndërmarrjes Editis Holding ("Editis") është një grup botues librash me bazë në Francë, ku përqendron pjesën më të madhe të aktivitetit të tij. Në një masë të

1

kufizuar krahasuar me aktivitetin e saj në Francë, Editis operon edhe në disa vende frëngjisht folëse si në Belgjikë, Luksemburg, Zvicër dhe Kanada (targeti).

Baza Ligjore dhe akti i Përqendrimit

Sipas nenit 13 të Ligjit 08/L-056 për Mbrojtjen e Konkurrencës, përmbushet detyrimi për të bërë njoftimin e Përqendrimit pasi që:

- a) *Qarkullimi i kombinuar i palëve në tregun ndërkombëtar e kalon shumën 20,000,000 Euro.*
- b) *Qarkullimi i një pale në tregun e brendshëm e kalon shumën 1,000,000 Euro.*
- c) *International Media Invest a.s. ("IMI") blerjen e aksioneve 100% të Editis Holding.*

Kërkesa për përqendrim është bërë për arsye ("IMI") kontrollon nga **EPCG** e cila ka shitje në Kosovë, përmes ndërmarrjeve:

Gjirafa Kosova LL.C, me numër të biznesit 810123860, me adresë në Graçanicë dhe Gjirafa, Inc – Dega në Kosovë, me numër të biznesit 810840307, me adresë në Graçanicë.

Pas pranimit të Njoftimit për Përqendrim, e paraqitur në bazë të Ligjit 08/L-056 Për Mbrojtjen e Konkurrencës dhe bazuar në nenet 11, 13, 17, 18, si dhe Udhëzimi Administrativ Nr. 06/2012, neni 18 dhe 20 paragrafi (1.3) Për Mënyrën e Paraqitjes së Kërkesës dhe Kriteret për Konstatimin e Përqendrimit të Ndërmarrjeve, Sekretariati ka filluar vlerësimin e kërkesës për Përqendrim.

Procedurat e ndjekura:

- 1. Vlerësimi i Lëndës;
- 2. Vërtetimi për Kërkesën e Dorëzuar me datë 21.06.2023;
- 3. Njoftimit për realizimin e përqendrimit në web faqen e AKRK-së me datë 22.06.2023;
- 4. Njoftimi për Përqendrim është i bazuar në Marrëveshjen lidhur me datë 23.04.2023; ndërmjet palëve IMI (blerësi), dhe Vivendi SE (shitësi) mbi/dhe Editis Holding (targeti).

II. Parashtruesi i njoftimit për Përqendrim obligohet të paguajë taksën administrative prej 100.00 € me shkronja (njëqind euro) dhe Autorizimin për Realizimin e Përqendrimit në përputhje me nenin 18, të ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës dhe nenit 20 të Udhëzimit Administrativ Nr. 06/2012, bëhet kundrejt pagesës në vlerë prej 3,000.00 € me shkronja, (tre mijë) Euro.

ARSYETIM

Autoriteti i Konkurrencës i Republikës së Kosovës, me datë 29.05.2023, me Nr. Prot. 242/23-11/H ka pranuar kërkesën për njoftim të Përqendrimit lidhur me marrjen e kontrollit të Editis Holding dhe blerjen e aksioneve 100% nga International Media Invest a.s.

Analiza e Konkurrencës

Komisioni konsideron se tregu i shitjes me pakicë të librave është kombëtar kur librat shiten në shtrirje në distancë, ose vendor kur ato shiten në librari.

Transaksioni nuk do të çojë në ndonjë mbivendosje horizontale midis CMI dhe Editis, sepse CMI nuk është aktive në sektorin e botimit të librave në Francë dhe Editis nuk është aktive në sektorin e botimi të revistave në Francë.

Nuk ka marrëdhënie vertikale midis sektorit të botimeve të librave dhe sektorit të botimit të revistave dhe as CMI dhe as Editis nuk janë aktive në ndonjë treg në rrjedhën e sipërme ose të poshtme nga aktivitetet e tyre përkatëse.

Se fundmi CMI nuk është aktive në asnjë sektor të lidhur me sektorin francez të botimit të librave dhe Editis nuk është aktiv në asnjë sektor të lidhur me sektorin e botimit të revistave. Prandaj, transaksioni nuk do të çojë në ndonjë treg të raportueshëm.

Sa i përket Kosovës, e cila nuk është pjesë e EEA-së, IMI dhe Editis nuk janë aktive dhe kështu nuk kanë asnjë pjesë tregu në fushën e shtypit të revistave dhe botimit të librave. Prandaj, transaksioni i propozuar nuk do të ketë ndikim në këto tregje dhe segmente të tyre në juridiksionin e Kosovës.

Tregu Relevant: pas transaksionit nuk do të ndryshoj tregu përkatës, në Republikën e Kosovës.

Tregu i produktit - botimi i librave, gazetave dhe revistave.

Tregu gjeografik - do të konsiderohet, tregu ndërkombëtarë, kryesisht; Francë dhe Çeki.

Efektet e konkurrencës në tregun përkatës, transaksioni i realizuar

Transaksioni i propozuar, do të realizohet në tregun gjeografik ndërkombëtar, kërkesa për njoftim të përqendrimit, është bërë për arsye se palët në përqendrim ndërmarrja IMI (blerësi) është pjesë e EPCG-së, që ka të hyra përmes shitjeve në Republikën e Kosovës. Sipas vlerësimit të përqendrimit, nga ky transaksion nuk do të ketë efekte negative për konkurrencën, e rrjedhimisht për konsumatorët në Republikën e Kosovës. Nga të dhënat e ofruara konsiderojmë se implementimi i transaksionit nuk mund të ketë efekt negativ në Kosovë, sepse palët nuk kanë veprimtari horizontale të biznesit të mbivendosura në Kosovë, d.m.th transaksioni nuk do të ndryshojë tregun dhe asnjë marrëdhënie vertikale. Kushtet e konkurrencës do të mbesin të njëjta si para transaksionit dhe pas transaksionit. Ndërmarrjet e përfshira në Përqendrim, nuk do të kenë efekt negativ në tregun kosovar, e rrjedhimisht nuk ka mundësi të kufizimit ose shtrembërimit të konkurrencës në treg, pasi që IMI është pjesë e grupit "EPCG" e cila gjeneron të ardhura nga shitjet, përmes Gjirafa Kosova LL.C, me numër të biznesit 810123860, me adresë në Graçanicë dhe Gjirafa, Inc – me numër të biznesit 810840307, në adresë në Graçanicë.

Shënim:

Çdo formë e shtrembërimit të konkurrencës, respektivisht sjellje anti - konkurruese do të jetë nën monitorimin e Autoritetit të Konkurrencës i Republikës së Kosovës.

Kërkesa për Përqendrim, merr epilogun si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

AUTORITETI I KONKURENCËS KOMISIONI

Neime Binaku-Isufi

Kryetare



Kaltrina Sela
Zv. Kryetare

A handwritten signature in blue ink, likely belonging to Kaltrina Sela.

Nafije Osdautaj
Anëtare

A handwritten signature in blue ink, likely belonging to Nafije Osdautaj.

III. Me këtë Vendim të njoftohen:

- Palët
- Arkiva